

|                                                                                   |                                                                                |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА<br/>KOMUNA E GRAÇANICËS<br/>MUNICIPALITY OF GRACANICA</b> |  |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|

Në bazë të nenit 12.2 pika d) dhe nenit 52 paragrafi 52.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 13.1 dhe nenit 26 paragrafi 26.2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e nëntë të rregullt, e mbajtur më datën 28.10.2025, merr këtë:

### VENDIM NR.52/2025/KG

### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT NËNTËMUJOR FINANCIAR PËR VITIN 2025

#### Neni 1

Raporti i miratuar nëntëmuJOR financiar për vitin 2025. është paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe raport:

| Nr. r. | Kategoria ekonomike       | Vlera e buxhetit | Alokimi për 9 muaj | Shpenzimet për 9 muaj | % të shumës së buxhetit | % të alokuara | % të alokimit të buxhetit |
|--------|---------------------------|------------------|--------------------|-----------------------|-------------------------|---------------|---------------------------|
| 1.     | Paga dhe medetje          | 4,725,758.37     | 3,654,157.51       | 3,345,273.16          | 70.79                   | 91.55         | 38.51                     |
| 2.     | Mallra dhe sherbime       | 1,949,438.68     | 1,865,316.01       | 1,204,673.52          | 61.80                   | 64.58         | 19.66                     |
| 3.     | Sherbime komunale         | 248,861.75       | 248,861.75         | 196,043.72            | 78.78                   | 78.78         | 2.62                      |
| 4.     | Subvencione dhe transfere | 654,773.40       | 654,773.40         | 485,124.94            | 74.09                   | 74.09         | 6.90                      |
| 5.     | Shpenzime kapitale        | 3,370,716.04     | 3,066,133.71       | 1,536,983.59          | 45.60                   | 50.13         | 32.31                     |
| 6.     | Donacione                 | 319.11           | 319.11             | 319.11                | 100.00                  | 100.00        | 0.00                      |
| 7.     | Rezerva                   | 89,446.00        | 0.00               | 0.00                  | 0.00                    | 0.00          | 0.00                      |
| 8.     | TOTAL                     | 11,039,313.35    | 9,489,561.49       | 6,768,418.04          | 61.31                   | 71.32         | 100.00                    |

Nga tabela e paraqitur shihet se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e tretë të vitit 2025 është 11,039,313.35€. Nga shuma e përgjithshme, 7,024,142.00€ janë grantet qeveritare, 2,729,206.00€ janë të hyrat e planifikuara vetanake për vitin 2025, 319.11€ janë donacionet, 1,072,955.87€ janë mjetet e transferuara nga viti 2024 dhe 212,690.37€ janë mjetet shtesë për mbulimin e deficitit për pagat dhe mëditjet në bazë të vendimit të Qeverisë.

Buxheti për vitin 2025 është ndarë në pesë grante:

- 1) Granti i përgjithshëm në një shumë prej 3,305,350.00€
- 2) Granti specifik për arsim në një shumë prej 1,898,336.00€
- 3) Granti specifik për shëndetësi primare në një shumë prej 529,685.00€
- 4) Granti specifik për shëndësi sekondare në një shumë prej 1,090,771.00€
- 5) Granti për shërbimet rezidenciale në një shumë prej 200,000.00€

Nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2025 për paga dhe mëditje është ndarë shuma prej 4,725,758.37€ apo 42,81%, për mallra dhe shërbime është ndarë shuma prej 1,949,438.68€ apo 17,66%, për shërbime komunale është ndarë shuma prej 248,861.75€ apo 2,25%, për subvencione dhe transfere është ndarë shuma prej 654,773.40€ apo 5,93%, për shpenzime kapitale është ndarë shuma prej 3,370,716.04€ apo 30.53% dhe për donacione shuma prej 319.11€ apo 0.00€ dhe për rezerva janë ndarë 89,446.00€ apo 0,81%.

Në nëntëmujorin e parë është bërë alokimi i mjeteve financiare në një shumë prej 9,489,561.49 apo 85,96% nga buxheti total. Alokimi i mjeteve financiare është bërë sipas kategorive ekonomike në shumat e mëposhtme:

- 1) Për paga dhe mëditje në një shumë prej 3,654,157.51€ apo 77.32% nga buxheti
- 2) Për mallra dhe shërbime në një shumë prej 1,865,316.01€ apo 95,68% nga buxheti
- 3) Për shërbime komunale në një shumë prej 248,861.75€ apo 100,00% nga buxheti
- 4) Për subvencione dhe transfere në një shumë prej 654,773.40€ apo 100.00% nga buxheti
- 5) Për shpenzime kapitale në një shumë prej 3,066,133.71€ apo 90,96%
- 6) Për donacione në një shumë prej 319.11€ apo 100,00%
- 7) Për rezerva në një shumë prej 0.00 apo 0.00%

Në nëntëmujorin e parë janë shpenzuar 6,768,418.04€ apo 61,31% nga buxheti i përgjithshëm apo 71,32% nga mjetet e alokuara për nëntë muaj.

Sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar:

- 1) Për paga dhe mëditje në një shumë prej 3,345,273,16€ apo 70,79% nga buxheti i përgjithshëm apo 91,55% nga mjetet e alokuara
- 2) Për mallra dhe shërbime në një shumë prej 1,204,673.52€ apo 61,80 % nga buxheti i përgjithshëm apo 64,58% nga mjetet e alokuara
- 3) Për shërbime komunale në një shumë prej 196,043.72€ apo 78,78% nga buxheti i përgjithshëm apo 78,78% nga mjetet e alokuara

4) Për subvencione dhe transfere në një shumë prej 485,124.94€ apo 74,09% nga buxheti i përgjithshëm apo 74,09% nga mjetet e alokuara

5) Për shpenzime kapitale në një shumë prej 1,536,983.59€ apo 45,60% nga buxheti i përgjithshëm apo 50,13% nga mjetet e alokuara

6) Për donacione në një shumë prej 319.11€ apo 100,00% nga buxheti i përgjithshëm apo 0,00% nga mjetet e alokuara

7) Për rezerva në një shumë prej 0.00€ apo 0,00% nga buxheti i përgjithshëm apo 0,00% nga mjetet e alokuara

Për nëntë muaj janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 2,251,055.00€ apo 82,48% nga të hyrat e planifikuara vetanake për vitin 2025 dhe të njëjtat janë alokuar në kategoritë ekonomike si në vijim:

- Në mallra dhe shërbime është alokuar shuma prej 87,153.33€
- Në shërbime komunale është alokuar shuma prej 10,000.00€
- Në subvencione është alokuar shuma prej 40,000.00€
- Në investime kapitale është alokuar shuma prej 2,113,901.67€

Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2024 janë shpenzuar 148,559.15€ më shumë apo për 2,24%, ndërsa të hyrat vetanake janë për 55,216.32€ apo për 2,39% më të ulëta në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2024.

## Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

